



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7094 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - nr. 28/2008 ), Statutin e Komunës neni 79, shkresën përcjellëse me numër 11/Nr.7094/2012 të datës 09.10.2012 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit me numër 11-Nr.6948/2012, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

## VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SHFRYTËZIMIN E PARCELËS Nr.1046-0

### I

I jepet në parim pëlqimi z.Nexhmedin Brava për shfrytëzimin e një pjese të parcelës Nr.1046-0 mal i klasit të pestë në vendin e quajtur „Osoj” e evidentuar në çertifikatën e pronësisë.Nr.100 pronë shoqërore e ekonomisë pyjore zona kadastrale Pustenik me një sipërfaqe prej  $S=0.05.77$  ha për ndërtimin e një objekti hoteleri-restorant.

### II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

### III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës

### IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlashi

